



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

**SHPLLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,  
LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NE DETYRE**

**“Drejtor” në Drejtorinë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore  
Kategoria e pagës II-b**

Në zbatim të nenit 25 dhe të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshua me te fundit nr. 748, date 19.12. 2018, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

- “Drejtor” në Drejtorinë Juridike dhe Çështjeve Gjyqësore
- Kategoria e pagës II-b

**Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë )  
aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave:**

**30 dhjetor 2020**

***\*Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:**

Realizimi i vlerësimeve ligjore në bazë të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe kryerja e analizave juridike të çdo rasti, për të bërë një oponentë konstruktive të çdo projekt-akti normativo-specifik, që ndikon mbi konkurrencën, si dhe për të siguruar një mbrojtje profesionale të bazuar në prova dhe ligj përballë padive në gjykata.

Përgjigjet për vlerësimin paraprak të njoftimeve të përqëndrimeve të njoftura në Autoritetin e Konkurrencës nëse përfshihen apo jo në kategorinë e përqëndrimeve në tregun gjeografik përkatës.

Kryerjen e analizave ligjore dhe krahasimore dhe njohje të legjislacionit të BE

## **I-Lëvizja paralele**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b),
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në “Shkencat Juridike”.
  - b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale, në fushën e konkurrencës, legjislacionit, procedurave administrative,
  - c) Të zotërojnë aftësi për të përcaktuar objektiva dhe prioritete.
  - d) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë.
  - e) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 4 vjet, në nivelin e mesëm drejtues.
- a) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
  - b) Të ketë eksperiencë në mësimdhënie.
  - c) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## 2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30 dhjetor 2020***

## 3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **31 dhjetor 2020** njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## 4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, te ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
- Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ” Për Mbrojtjen e Konkurrencës” te ndryshuar dhe akteve nën ligjore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative

d) Për më shumë: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)

## 5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

## 6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## II- Ngritja në detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 26 të ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.*

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë:

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- f) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në “Shkencat Juridike”.  
Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale, në fushën e konkurrencës, legjislacionit procedurave administrative, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe prioritete.
- g) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë.
- h) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 4 vjet, në pozicione të nivelit të ulët drejtues.
- d) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
- e) Të ketë eksperiencë pune në mësimdhënie.
- f) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.
- g) Të zotërojnë aftësi të mira të punës në grup.

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listes së notave;

c) fotokopje të librezës së punës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

d) Vërtetim i gjendjes gjyqësore

dh) Numer kontakti dhe adresë vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi, brenda datës **30 dhjetor 2020** në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, kati IV. Nr.4.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **31 dhjetor 2020**.